



**Hapet Thirrja për mobilitete (bursa) stafi të UPT-së
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus +
në Università degli Studi G.D'Annunzio Chieti Pescara, Itali.**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Università degli Studi G.D'Annunzio Chieti Pescara.

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e stafit akademik dhe administrativ, me synim zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis dy institucioneve.

Fusha e mësimdhënies/trajnitimit:

- Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës;
- Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit;
- Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave;
- Drejtoritë në UPT.

Numri total i stafit: Numri total i stafit akademik dhe administrativ do të përcaktohet nga universiteti pritës, pas nominimit nga UPT.

Koha e kryerjes së mobilitetit: 5 ditë + 2 ditë udhëtim, semestri i II i vitit akademik 2022 – 2023, (Mobilitetet duhet të përfundojnë brenda muajit korrik 2023).

Dokumentat e nevojshme për aplikim :

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës, për stafin akademik **;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching/Training) për stafin akademik/administrativ në universitetin pritës***.

**Plani i mobilitetit dhe periudha e propozuar e mobilitetit duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

***Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobiliteteve si staf akademik për mësimdhënie në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aprovues, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera për aplikimin tuaj.*

**** Mobility Agreement for Teaching/Training për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Për të shkarkuar formatet: Staff Mobility for Training dhe Staff Mobility for Teaching, ju lutemi klikoni te: [Aneks 3](#) , [Aneks 4](#) .

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: 21 prill 2023, ora 12.00.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, si dhe **për aspektin financiar të mobilitetit**, ju lutemi kontaktoni në email: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al